



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.84 dt.15.05.1997

**“PËR NGRITJEN E NJE SKUADRE PRANE NDERMARRJES SE
KUARTALLEVE PER ZHDUKJEN E QENVE RRUGACE”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.05.1997, pasi shqyrtoi e miratoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Veterinarisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve “Për ngritjen e një skuadre pranë Ndërmarrjes së Kuartalleve për zhdukjen e qenve rrugaçë”, në mbështetje të nenit 14 të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Miratimin në parim për domosdoshmërinë e ngritjes së një skuadre me pushkatar(gjuetarë) pranë Ndërmarrjes së Kuartalleve për zhdukjen e qenëve rrugaçë, aktivitet i cili do të vazhdojë gjatë gjithë vitit 1997. Në këtë skuadër do të aktivizohen gjithsej 8 persona që do të mbulojnë të gjithë zonat e qytetit të Tiranës.
2. Dhënien e një fondi prej 1.700.000(një milion e shtatëqindmijë) lekë, në të cilin përfshihen pagat, blerja e armëve(çifteve) dhe bazës tjetër materiale, transportit dhe zhdukja e kadavrave etj. Këto fonde do të administrohen nga Ndërmarrja e Kuertalleve.
3. Emërimin e një përgjegjësi, specialist i lartë me profil mjekë veteriner apo zooteknik.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Veterinarisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Përgjithshme Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Financës dhe Ndërmarrja e Kuartalleve.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

